



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS  
DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË STANDARDEVE DHE ADMINISTRIMIT TË  
NDIHMËS DYTËSORE  
SEKTORI I MONITORIMIT TË OFRUESVE TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE  
DHE DYTËSORE

Nr. 192/Prot.

Tiranë, më 3.10.2025

**NJOFTIM PUBLIK**

**“PËR NJOFTIMIN E EKZEKUTIMIT VULLNETAR TË DETYRIMIT PËR Z.  
SKËNDER BINJAKU NË ZBATIM TË VENDIMIT NR.284, DATË 21.03.2025, TË  
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM  
ELBASAN”**

*Lagjia “Haxhias”, Rruga “Faik Neziri” Pallati nr.590/1 hyrja.A, Elbasan  
Cel: 0684430834*

Me Vendimin nr. 284, datë 21.03.2025, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në procesin me palë paditëse znj. Sonila Binjaku (*referuar vendimit nr. 592, datë 04.10.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan*), ku znj. Sonila Binjaku është përfituese e Ndihmës Juridike Dytësore dhe të paditur z. Skënder Binjaku me objekt: “Zgjidhje martese, lënien e fëmijës Oksel Binjaku për rritje dhe edukim mua paditësës, i padituri të paguajë pensionin ushqimor për fëmijën Oksel Binjaku, e etj”, ku gjykata shpreh që shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palëve ndërgjyqëse në masën 50% secili.

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka likujduar për shërbimin e ofruara ekspertin Najada Matraxhiu me vlerë 30 000 lekë.

Për sa më sipër, në mbështetje të Nenit 30 të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” si dhe Kodit të Proedurës Civile, ju lajmërojmë për kryerjen e ekzekutimit vullnetar brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, në zbatim të Vendimit nr. 284, datë 21.03.2025, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shumës prej 15 000 lekë, të paguara nga ana jonë për shpërblim eksperti për përfituesin e ndihmës juridike dytësore falas znj. Sonila Binjaku.

**Shlyerja e ekzekutimit vullnetar të kryhet në llogarinë e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas më NIPT L11704452P.**

Në rast se vendimi nuk ekzekutohet vullnetarisht, me kërkesë të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, shërbimi përmbarimor gjyqësor fillon procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm, sipas legjislacionit në fuqi.

Nga njoftimi i bërë nga shërbimi postar ka rezultuar i pamundur kontakti me z. Skënder Binjaku. Në këto kushte referuar nenit 148 e në vijim të Kodit të procedurës Administrative kur njoftimi është i pamundur, në respektim të të drejtave ligjore, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas vendosi që njoftimi të bëhet nëpërmjet shpalljes publike në këndin e njoftimeve në Bashkinë Elbasan, si dhe në faqen web të Drejtorisë. Ky njoftim duhet të qëndrojë jo me pak se 20 ditë.

Njoftimi quhet i bërë kur Bashkia Elbasan depoziton në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas një kopje të aktit bashkë me dokumentat që vërtetojnë shpalljen publike.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
NË MUNGESË**

**(DREJTOR I DREJTORISË SË ZBATIMIT TË POLITIKAVE DHE ADMINISTRIMIT  
TË NDIHMËS PARËSORE)**

**Patricia Pogaçe**

